



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 22.10.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË FUSHË  
KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR  
MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Imer Vitija dhe anëtarëve të ekipit Kreshnike Haziri dhe Shefkije Beka, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Zuke Zuka.

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                     |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje e përgjithshme .....                                                    | 4  |
| 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....  | 7  |
| 2 Qeverisja.....                                                                    | 11 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....                                           | 16 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....                                 | 27 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA ..... | 28 |
| Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....           | 30 |
| Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....                                                   | 33 |

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 03.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më gjerësisht, shih Shtojcën 1 të këtij raporti.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksimi i çështjes**

Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se komuna kishte klasifikuar disa shpenzime në kode jo adekuate, duke paguar nga investimet kapitale për mallra/shërbime dhe subvencione shumë totale prej 345,755€. Shuma e klasifikuar në kode të gabuara ekonomike ishte aprovuar edhe me Tabelat e buxhetit vjetor 2016.

Po ashtu, komuna nuk ka arritur të regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1000€.

Për më gjerësisht, shih kapitullin 1.1 të këtij Raporti.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### **Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Ne kemi kryer Auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

## Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Prej mostrave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë financime nga investimet kapitale për mallra/shërbime dhe subvencione në shumën totale prej 345,755€. Arsyeja e keq klasifikimit ishte planifikimi jo i mirë i buxhetit nëpër kategori ekonomike. Vlen të sqarohet se vlera prej 140,862€ e destinuar për bashkëfinancim të investimeve kapitale, ishte paguar për subvencionimin e bujqëve (serra, kultivatorë, laktofriza, koshere të bletëve etj); Shpenzimet në vlerë prej 182,818€ për projektin ("Mirëmbajtja, pastrimi i ambientit, ngritja e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak, ambulantorë" që janë aprovuar si investime kapitale, në fakt janë paguar për një projekt të shërbimeve, dhe nuk janë materializuar në pasuri. Pagesat totale prej 15,551€ nga investimet kapitale janë bërë për shërbime të përkujdesit social shëndetësor nga projekti "Mirëmbajtja investive", ndërsa nga kategoria mallra dhe shërbime, janë bërë pagesa për subvencione prej 6,524€.
- Pagesat e sipër përmendura, nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale; dhe
- Komuna nuk ka arritur që të regjistrojë pasurinë e plotë nën 1000€, pasi që blerjet prej 51,172€ (kontejnerë plastik) nuk janë paraqitur në regjistrin e-pasuria.

## Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.



Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat buxhetore të Ligjit për buxhetin e Kosovës nr.05/L-071, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-109 për rishikim buxhetor;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Kërkesat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Planin e veprimtimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntë mujore me kohë; raportet operative (të performancës), nëse ka;
- Planin vjetor të prokurimit; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, çështjet në lidhje me kornizën raportuese nuk ishin adresuar me rastin e përgatitjes së draft Pasqyrave financiare, ku kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë në vijim:

- PFV janë përpiluar pa e marr parasysh kërkesën e formës standarde të nxjerrë nga MF, ku të dhënat kërkohet të paraqiten në (000) mijëshe; dhe
- Te neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, shënimi nëntë (9) buxheti fillestar dhe buxheti final, të hyrat tatimore dhe jo tatimore nuk janë paraqitur në vlera të ndara.

Pas sugjerimeve tona, pasqyrat financiare janë korrigjuar.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

#### DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtarit Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë. Çështjet që kanë bëjnë me keq klasifikim të shpenzimeve dhe menaxhimit të pasurisë (nën 1000€) janë theksuar në opinionin e auditimit, por që nuk janë konsideruar me ndikim material për opinion.

### 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Procesi buxhetor duhet të jetë reflektim i shpenzimeve reale në mënyrë që të gjitha shpenzimet të klasifikohen sipas kodeve adekuate. Gjithashtu, para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato duhet t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre.

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për çdo komunë, që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo është një tregues se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga komuna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Procedurat e një qeverisjeje të mirë kërkojnë që aktivitetet strategjike, edhe ato operacionale të zbatohen dhe monitorohen në mënyrë efektive. Ne kemi identifikuar se komuna ka arritur të përpilon Planit Zhvillimor Strategjik 2016-2020, por jo edhe Planet Operative të njësive organizative. Mungesa e këtyre planeve operative vazhdon të ndikoj dhe të mbetet sfidë edhe më tutje në zhvillimin e sistemit të qeverisjes së mirë.

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga ana e komunës, pasqyron një situatë më të mirë krahasuar me vitin e kaluar duke u bazuar në dëshmi. Mirëpo, procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur.

Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi i auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, mbeten ende sfidues për komunën.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2015 të komunës ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan të veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet.

Deri në përfundimin e periudhës së auditimit 2016, dy (2) rekomandime ishin zbatuar, pesë (5) ishin në proces të zbatimit dhe shtatë (7) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

### Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

|                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E gjetura</b>     | Nga të dhënat në paragrafin më lartë shihet gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë zbatuar, për shkakun se komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar veprimet e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Rreziku</b>       | Përsëritja e disave prej rekomandimeve të vitit të kaluar dhe viteve të mëparshme, tregon për dobësi të kontroleve të brendshme në sisteme kryesore financiare që kanë rezultuar në veçanti në: keq klasifikimin e shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate si rezultat i planifikimit të gabuar të buxhetit, dobësi në procesin e prokurimit, rritje të obligimeve, dobësitë në menaxhimin e të hyrave vetjake, rritje të llogarive të arkëtueshme, dhe performancë të ultë të NJAB dhe komitetit të auditimit. |
| <b>Rekomandimi 2</b> | Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar, dhe të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen në tërësi. Për ta përmirësuar procesin, raportet e progresit në zbatimin e rekomandimeve duhet të shqyrtohen çdo tremujor dhe mekanizmi i llogaridhënies duhet të vendoset.                                                                     |

## 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese të komunës. Vlerësimi i pyetësorit nga ana jonë nuk ka për qëllim të ofroj komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 3 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i mesëm

|                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E gjetura</b>     | <p>Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga komuna ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale;</li> <li>Strategjia gjithëpërfshirëse e planit zhvillimor komunal konsiderohet si e vendosur, por jo edhe planet tjera operative; dhe</li> <li>Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe projekteve buxhetore të planifikuara kërkon një rishikim më gjithëpërfshirës, për faktin se komuna ka klasifikuar disa shpenzime në kode jo adekuate e që projektet e paraqitura në tabela buxhetore, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale.</li> </ul> |
| <b>Rreziku</b>       | <p>Aranzhimet e dobëta të qeverisjes, veçanërisht në fushën e klasifikimit të shpenzimeve, ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë mundësinë e reagimit me kohë ndaj rreziqeve potenciale.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Rekomandimi 3</b> | <p>Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës së rreziqeve, përmirësimin e planifikimeve buxhetore për të evituar keq klasifikimin e shpenzimeve dhe adresimin e fushave tjera ku janë identifikuar dobësitë.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna e Fushë Kosovës operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

### 2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

#### Çështja 4 - Mungesa e planeve operative - Prioritet i lartë

|                      |                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E gjetura</b>     | Komuna ka të aprovuar një strategji të përgjithshme zhvillimore, dhe gjatë vitit 2016 ka hartuar planin zhvillimor 2016-2020, por nuk ka arrit të përgatitë edhe planet tjera operative për zhvillimin e sektorëve komunal.                                                |
| <b>Rreziku</b>       | Mos arritja e përgatitjes së planeve të veçanta operative për zhvillimin e sektorëve rrezikon zbatimin e strategjisë dhe bën të pamundur përcjelljen e përmbushjes së objektivave në pikëpamje të vizionit të komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë. |
| <b>Rekomandimi 4</b> | Kryetari duhet të siguroj hartimin e planeve operative, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së rezultateve kundrejt objektivave dhe të vendos procese efektive të mbikëqyrjes.                                                                   |

### 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Nga aspekti i raportimit menaxherial është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

#### Çështja 5 - Kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

|                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|----------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E gjetura</b>     | Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar të komunës ka nxjerrë dobësi në nivelet e kontrolleve. Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë forcim, në veçanti në lidhje me: planifikimin e prokurimit dhe ndarjeve adekuate të fondeve nëpër kategoritë ekonomike, obligimeve të pa paguara dhe të arkëtueshmeve. |
| <b>Rreziku</b>       | Cilësia jo e mirë e kontrolleve nga menaxhmenti, redukton aftësinë për të reaguar me kohë dhe menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës, dhe për të përballuar në mënyrë të suksesshme sfidat ekzistuese.                                                                                                                                                        |
| <b>Rekomandimi 5</b> | Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve menaxheriale dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrole të përshtatshme, në fushat ku janë identifikuar dobësitë.                                                                                                                     |

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) operon në përbërje prej dy auditorësh. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm (AB) duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga Komiteti i Auditimit. Në lidhje me këtë, ne marrim në konsideratë punën e auditorëve të brendshëm, veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë në adresimin e rekomandimeve si dhe angazhimet e komitetit të auditimit.

NJAB kishte përgatitë planin strategjik dhe vjetor të auditimit dhe raportet tre mujore të cilat i ka dërguar në Njësine Qendrore Harmonizuese. NJAB ka planifikuar gjashtë (6) auditime për vitin 2016, kurse ka arritur t'i finalizoj vetëm dy (2) prej tyre. Raporti i parë ka të bëjë me procedurat e regjistrimit dhe monitorimit të pasurive, kurse i dyti me të hyrat vetjake për drejtorinë e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës. Në vitin 2016, Komiteti i Auditimit (KA) ka mbajtur dy takime, ku janë shqyrtuar raporti financiar i komunës për vitin 2015, analizimi i planit vjetor të (AB), rekomandimet e auditorit të ZKA-së dhe shkaqet e mos zbatimit të tyre. Megjithatë, nuk është vërejtur se KA ka kontribuar në përmirësimin e punës të NJAB.

### Çështja 6 - Zbatimi i rekomandimeve të NJAB dhe Komiteti i Auditimit - Prioritet i lartë

|                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E gjetura</b>     | Menaxhmenti i komunës nuk kishte bërë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB, andaj kjo ka rezultuar me përsëritjen e çështjeve të rekomanduara.                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|                      | Komiteti i auditimit nuk ka arritur t'i shqyrtoj raportet e auditorit të brendshëm të realizuara gjatë vitit 2016 dhe nuk ka përgatitur raport gjithëpërfshirës për menaxhmentin, me kërkesë që të merren veprime konkrete në zbatimin e rekomandimeve të AB.                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Rreziku</b>       | Niveli i dobët i realizimit të planit të auditimit nga NJAB, mos hartimi i planit të veprimit nga menaxhmenti për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB dhe dështimi i komitetit të auditimit në përmbushjen e rolit të tij mbikëqyrës, rrit rrezikun që dobësitë e identifikuara të mos korrigjohen, dhe të njëjtat të përsëriten nga viti në vit.                                                                                                              |
| <b>Rekomandimi 6</b> | Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për rekomandimet e AB, dhe të kërkoj nga bartësit përgjegjës ku janë dhënë rekomandimet, që në mënyrë formale të raportojnë mbi zbatimin e tyre, të siguroj se NJAB fokuson rishikimet e saj në fushat që përmbajnë një shkallë të lartë të rreziqeve operative dhe, komiteti i auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj temat që do t'i trajtoj me prioritet gjatë vitit. |



### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: planifikimi i buxhetit dhe i shpenzimeve për kategori ekonomike, përkatësisht klasifikimi adekuat i shpenzimeve, menaxhimi obligimeve dhe i të arkëtueshmeve.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

| Përshkrimi         | Buxheti fillestar | Buxheti Final    | 2016 Pranimet    | 2015 Pranimet    | 2014 Pranimet    |
|--------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Të hyrat vetjake   | 2,350,000         | 2,427,787        | 2,262,738        | 2,034,210        | 2,288,351        |
| Dënimet e policisë |                   |                  | 130,754          |                  |                  |
| Gjobat e gjykatave |                   |                  | 34,295           |                  |                  |
| <b>Totali</b>      | <b>2,350,000</b>  | <b>2,427,787</b> | <b>2,427,787</b> | <b>2,034,210</b> | <b>2,288,351</b> |

Të hyrat e inkasuara për vitin 2016, krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 393,577€. Kryesisht rritja ka rezultuar nga të hyrat e taksave komunale për regjistrimin e trashëgimisë, legalizimin e objekteve dhe nga të hyrat e tatimit në pronë. Mjetet nga të hyrat vetjake ishin destinuar për investime kapitale, mallra e shërbime, komunalit dhe subvencione.



**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                                | Buxheti fillestar | Buxheti Final <sup>2</sup> | 2016 Realizimi   | 2015 Realizimi   | 2014 Realizimi   |
|-------------------------------------------|-------------------|----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>Burimet e Fondeve:</b>                 | <b>8,578,620</b>  | <b>9,844,668</b>           | <b>8,210,069</b> | <b>8,268,351</b> | <b>7,876,173</b> |
| Granti i Qeverisë -Buxheti                | 6,228,620         | 6,282,898                  | 6,261,168        | 6,399,365        | 5,934,196        |
| Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> |                   | 1,045,419                  | 659,656          | 793,102          | 452,821          |
| Të hyrat vetjake <sup>4</sup>             | 2,350,000         | 2,350,000                  | 1,181,936        | 1,055,547        | 1,489,156        |
| Donacionet e brendshme                    |                   | 128,329                    | 69,309           |                  |                  |
| Donacionet e jashtme                      |                   | 38,022                     | 38,000           | 20,337           |                  |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,266,048€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme prej 38,022€, donacioneve të brendshme prej 128,329€ të hyrave të bartura nga viti paraprak 1,045,419€, ndërsa granti qeveritar është rritur për 54,278€ në vitin 2016. Në total, komuna ka përdorur 83% të buxhet final, me një rënie prej 5% krahasuar me vitin 2015.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi                                              | Buxheti fillestar | Buxheti Final    | 2016 Realizimi   | 2015 Realizimi   | 2014 Realizimi   |
|---------------------------------------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b> | <b>8,578,620</b>  | <b>9,844,668</b> | <b>8,210,269</b> | <b>8,268,351</b> | <b>7,876,173</b> |
| Pagat dhe Mëditjet                                      | 4,288,461         | 4,425,961        | 4,405,372        | 4,266,183        | 3,903,283        |
| Mallrat dhe Shërbimet                                   | 564,245           | 717,329          | 714,238          | 707,486          | 645,117          |
| Shërbimet komunale                                      | 150,000           | 149,809          | 149,710          | 169,390          | 190,664          |
| Subvencionet dhe Transferet                             | 274,675           | 443,077          | 383,933          | 389,231          | 711,981          |
| Investimet Kapitale                                     | 3,301,239         | 4,108,492        | 2,557,016        | 2,736,061        | 2,425,128        |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Buxheti final për investime kapitale është rritur me vendim të Qeverisë prej 807,253€, ndërsa niveli i ekzekutimit për këtë kategori ishte 62%. Kategoritë tjera, si pagat e mëditjet, mallrat e shërbimet dhe shërbimet komunale kishin trend pozitiv të ekzekutimit të buxhetit mbi 99%, kurse subvencionet 87%.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pa shpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara sipas buxhetit fillestar për vitin 2016 ishin 2,350,000€, kurse realizimi 2,427,787€ që është e barabartë me shumën e buxhetit final. Këto të hyra kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat administrative, të hyrat nga qiratë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga dënimet në komunikacion dhe të hyrat nga gjrobat e gjykatave për komunën.

#### Çështja 7 - Ndërtimi i objektit afarist - banesor pa leje ndërtimi - Prioritet i lartë

- E gjetura** Me rastin e dhënies së lejes së ndërtimit për një objekt, kishte pasur vonesë me pajisjen e lejes më gjatë se 30, respektivisht 45 ditë nga aplikimi sipas ligjit për ndërtimet 04/L-110. Kërkesa për aplikim ishte më 24.03.2014, ndërkaq leja e ndërtimit është dhënë pas dy viteve, më 20.07.2016.
- Gjatë ekzaminimit fizik, konstatuam që gjatë kësaj periudhe, objekti ishte ndërtuar, ndërsa komuna, respektivisht drejtoria e inspektoriatit nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim ndalese, dhe si rrjedhojë, nuk dihet nëse janë respektuar kushtet ndërtimore.
- Rreziku** Mungesa e inspektimeve të objekteve ndërtimore nga komuna, rrit rrezikun që të bëhen keqpërdorime gjatë ndërtimit në kundërshtim me kushtet urbanistike dhe mos realizimin e të hyrave të planifikuara nga kjo veprimtari.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurohet që secili objekt të inspektohet, të sigurohet që mos të ndërtohen objekte para se të pajisen me lejet përkatëse në pajtim me ligjin mbi ndërtimin dhe sipas kushteve ndërtimore urbanistike, dhe të hyrat të inkasohen sipas planifikimit dhe rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat

**Çështja 8 - Tatimi në pronë - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Komuna për vitin 2016 ka planifikuar 550,000€, ndërsa ka faturuar 649,480€, Deri më 31.12.2016, komuna ka inkasuar 616,000€. Kjo tregon se kishte shpërputhje të mëdha në mes planifikimit për të hyrat nga tatimi në pronë, faturimit dhe shkallës së inkasimit.

Borxhi i akumuluar nga tatimi në pronë vazhdon të mbetet i lartë (2,415,326€). Komuna ka filluar ta aplikoj ligjin e faljes së borxheve, ku nga lista totale e tatimpaguesve nuk janë larguar të gjithë personat e amnistuar, lista nuk është përditësuar, prandaj edhe vlerat nuk mund të jenë të sakta. Gjithashtu, komuna nuk ka arritur të bëjë verifikimin vjetor të 1/3 të pronave, siç kërkohet me ligjin e tatimit në pronë.

**Rreziku** Dallimi ndërmjet planifikimit, faturimit dhe realizimit, tregon planifikim jo real të tatimit në pronë. Mos konsistenca e procesit në fushën e të hyrave ndikon në pamundësinë e planifikimit të projekteve për t'u financuar nga burimet vetjake, apo shfaqjen e suficiteve/deficiteve të hyrave në fund të vitit.

Po ashtu, mos përditësimi i bazës së tatimpaguesve dhe mos verifikimi i pronave totale të tatueshme, rritë rrezikun që komuna të mos i ngarkoj në mënyrë adekuate pronat aktuale dhe të diskriminojë obliguesit të cilët paguajnë tatimin në pronë.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurohet që planifikimi i buxhetit për vitin vijues të jetë i bazuar në inkasimet e vitit aktual, në mënyrë që të hyrat të jenë konform planifikimit dhe pritshmërisë së inkasimit. Komuna duhet të bëjë plan konkret për të minimizuar borxhet e akumuluar nga 2003. Tatimpaguesit të cilët paguajnë borxhet sipas ligjit, të fshihen nga regjistrat e komunës për borxhet e akumuluar dhe lista të përditësohet deri në fund të vitit 2017, si dhe në baza vjetore të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave të komunës.

**Çështja 9 - Taksat e regjistrimit të veprimtarisë së biznesit - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Komuna nuk ka planifikuar të hyra nga ushtrimi i veprimtarisë së biznesit, edhe pse bën vjeljen e të hyrave nga kjo veprimtari. Komuna për vitin 2016 kishte ngarkuar bizneset me 144,461€, mirëpo deri më 31.12.2016, kishte inkasuar vetëm 12,632€. Nga 1443 biznese, të cilat operojnë në territorin e komunës dhe të cilat janë të ngarkuara me taksat e bizneseve nga vitet paraprake, komuna nuk bën faturimin e rregullt për obligimet mujore apo edhe borxhet e mbetura. Në vitin 2016, regjistrimi i borxheve të pa inkasuara nga veprimtaritë e biznesit ishte 799,498€ që do të thotë të arkëtueshmet vazhdojnë të rriten çdo vit.

**Rreziku** Mungesa e politikave efektive dhe faturimit të rregullt në këtë fushë ka ndikuar në akumulimin e shumave të larta të borxheve. Mos planifikimi i të hyrave nga ky zë rrit rrezikun e keq menaxhimit në mbledhjen e të hyrave si dhe mundësinë e pagesave në mënyrë selektive. Si rezultat, nuk do të mund të realizohen projektet kapitale të planifikuara nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurohet që të bëhet një plan për inkasimin e të hyrave nga taksat e biznesit, duke faturuar çdo biznes në baza të rregullta mujore, të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive që ushtrojnë veprimtari dhe të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmëve të akumuluar ndërsa vite.

#### **Çështja 10 – Shfrytëzimi pa kontrata valide i pronave të komunës - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Nga lista e shfrytëzuesve të pronës publike/qiramarrësve dhe qiramarrësit e banesave kolektive, kemi vërejtur se në disa raste kontratat nuk janë valide. Kontratat kishin skaduar në muajt paraprak, mirëpo prona e komunës shfrytëzohet ende pa ndonjë bazë ligjore.

**E gjetura** Banesat e dhëna për rastet sociale, sipas Ligjit 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe udhëzimeve administrative duhet të ngarkohen të paktën me vlerë minimale. Përkundër vlerës minimale për pagesë, borxhet nga 2012 nuk janë inkasuar dhe vazhdimisht janë në rritje. Kjo është si pasojë e mungesës së planeve konkrete për zgjedhjen e ndonjë mënyre më të lehtë dhe të pranueshme nga familjet që i shfrytëzojnë ato banesa, për inkasimin e borxheve të pa mbledhura edhe nga vitet paraprake.

**Rreziku** Shfrytëzimi i pronës publike pa kontratë valide rrit rrezikun që këto prona të keqpërdoren, që borxhet të vjetërsohen, të shndërrohen në borxhe të këqia dhe të mos inkasohen asnjëherë.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të marr masat për t'i pajisur qiramarrësit me kontrata në mënyrë që të kenë bazë ligjore të shfrytëzimit të pronave të saj, dhe të shqyrtoj mundësitë reale për trajtimin e borxheve të mbetura nga qiratë. Në të kundërtën, pronat publike duhet t'i rikthehen në zotërim të plotë komunës.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollët që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave çdo muaj, duke i nënshkruar listën e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Buxheti për këtë kategori për vitin 2016 ka qenë i planifikuar 4,425,961€, ndërsa është shpenzuar 4,405,372€ apo mbi 99%.

#### Çështja 11- Kontratat me mësimdhënës për Shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna ka angazhuar me vendim dy mësimdhënës për lëndët e Gjuhës shqipe dhe Matematikë në shkollën fillore e mesme e ulët "Selman Riza", në kohëzgjatje prej tre muajsh. Njëri mësimdhënës me kualifikim Bachelor i Sociologjisë është pranuar për lëndë të matematikës. Në anën tjetër, të punësuarve nuk u janë paguar kontributet pensionale dhe tatimi në pagë, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në të ardhurat personale nr. 03/L-161.
- Rreziku** Angazhimi i mësimdhënësve joadekuat sipas përvojës dhe kualifikimit, mund të rezultoi me performancë jo të kënaqshme në procesin mësimor dhe në suksesin e nxënësve. Shmangia nga pagesa e tatimeve dhe kontributeve të punësuarve me kontratë për marrëveshje të veçanta mund të ndikoj në ndëshkimin e komunës nga ana e autoriteteve tatimore.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të rishikoj rastet për të cilat janë angazhuar mësimdhënësit dhe të konsideroj nëse angazhimet e tilla janë të përshtatshme për pozitat e caktuara. Në anën tjetër, të sigurohet se tatimet dhe kontributet janë paguar sipas ligjit në fuqi për tatimin në të ardhura personale.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit për vitin 2016 ishte 867,138€, ndërsa gati po aq edhe ishin shpenzimet (863,948€). Ato kanë të bëjnë me furnizim me pajisje dhe inventar, materiale të zyrës, shërbime kontraktuese, derivate, etj.

#### Çështja 12- Anashkalimi i procedurave të prokurimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Pagesa në vlerë 1,712€ e datës 24.02.2016 është paguar për transportin e nxënësve në relacionin Bardh i Madh-Sllatinë e Madhe në bazë të një memorandumi të mirëkuptimit që nga 2014, duke anashkaluar procedurat e hapura të prokurimit.

Për të hartuar projektin ideor “Ndriçimi i parkut të lojërave të fëmijëve”, shuma prej 1,000€ i është paguar një eksperti të jashtëm, pa procedura të hapura të prokurimit, duke u bazuar në propozimin e ofruar direkt nga përfituesi.

**Rreziku** Pagesat e tilla të parregullta rrisin rrezikun e shkeljeve ligjore të rregullave të prokurimit dhe atyre të shpenzimeve të parasë publike.

**Rekomandimi 12** Kryetari i komunës duhet të sigurohet se të gjitha pagesat kryhet vetëm atëherë kur të jenë aplikuar proceset e rregullta të prokurimit dhe të jenë përmbushë kërkesat ligjore për shpenzimet e parasë publike.

#### Çështja 13 - Pagesa në avans nga Drejtoria e kulturës - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Drejtoria e kulturës ka tërhequr avans në vlerë 1000€ (të shpenzuara 960€) për ta financuar ansamblin “Zëri i Kosovës” për pjesëmarrje në festivalin nacional shqiptar të mbajtur në Tiranë. Në këtë rast nuk janë përfillur procedurat adekuate të shpenzimit të parasë publike. Financimet e tilla duhet të paguhet nga kategoria përkatëse e subvencioneve dhe direkt në llogarinë e përfituesit, e jo me para të gatshme.

**Rreziku** Pagesat e tilla për financime të ngjashme janë në kundërshtim me rregullat financiare të Thesarit dhe rrisin rrezikun e keqpërdorimit të mjeteve dhe qëllimit të shpenzimit.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të rishikoj funksionimet e kontrolleve të brendshme për shpenzimet e parasë publike, dhe të siguroj se me rastin e procedimit të pagesave janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore.

### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Komuna e Fushë Kosovës sipas ligjit të buxhetit kishte të ndara për subvencione dhe transfere 443,077€ ndërkaq ka shpenzuar 383,933€ apo 87% të fondeve në dispozicion. Komuna ka subvencionuar kryesisht entitetet jo publike për t'i mbështetur aktivitetet sportive-kulturore, rastet sociale, subvencionime për bujqësi dhe raste të tjera.

#### Çështja 14 – Pagesa e pagave dhe mëditjeve nga kategoria e subvencioneve - Prioritet mesëm

- E gjetura** Nga kategoria e subvencioneve janë bërë dy pagesa: vlera 439€ është bërë për punë jashtë orarit dhe 381€ janë paguar për kompensim të pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Pagesa të tilla duhet të bëhen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Pagesat e tilla nuk parashihen në rregulloren e brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve të duhura në respektimin rregullores së brendshme, bën që buxheti i ndarë për kategorinë e subvencioneve të mos shpenzohet për qëllimet e planifikuara dhe planet të mbesin të pa përmbushura.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj që pagesat për subvencione të jenë në harmoni me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe se pagesat nga kjo kategori të bëhen vetëm për pagesat që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,108,492€, prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 2,557,016€ apo 62%. Ato kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale.

#### Çështja 15 - Mos përfshirja e projekteve në planin e prokurimit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Projekti "Renovimi i objektit të IP "Gëzimi ynë", rregullimi i nyjeve sanitare në ShFMU "Daut Bogujevci" dhe i dyshemesë në ShFMU "Lismiri" në vlerë totale 10,712€, si dhe projekti "Renovimi dhe lyerja e mureve brenda dhe jashtë e sallës së sporteve në Fushë Kosovë" në vlerë 4,452€, nuk ishin të parapara në planin e prokurimit.
- Rreziku** Realizimi i projekteve jashtë planifikimeve fillestare mund të çrregulloj projeksionet buxhetore, dhe të ndikoj në mosrealizimin e projekteve të planifikuara me planin vjetor të prokurimit.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të nenit tetë (8) LPP, ku kërkohet që të vlerësohen nevojat vjetore për shpenzime sipas buxhetit dhe projekteve të planifikuara, përkatësisht të aprovuara.

#### Çështja 16 - Mosrespektimi i kriterëve të vendosura në Dosje të Tenderit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë "Ndërtimi i shtëpisë pritëse me karakter shoqëror në fshatin Sllatinë e Vogël" (6,012€), si kriter ishte kërkuar vërtetimi nga Administrata Tatimore se Operatori Ekonomik nuk ka borxhe të pa paguara. Në raportin e vlerësimit të tenderit, ky kriter nuk është marrë në konsiderim nga komisioni vlerësues. Ndërsa në dosjen e tenderit është hasur në vërtetimin e lëshuar nga ATK ku shihet se OE ka pasur borxhe të pashlyera.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit gjatë vlerësimit të ofertave, ka rezultuar me shpërblim të kontratës për operatorin ekonomik të pa përgjegjshëm.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të rishikoj pse në rastin më sipër nuk janë zbatuar kërkesat e prokurimit dhe siguroj që në të ardhmen zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE e përgjegjshëm.



## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Komuna ka arritur brenda vitit 2016 të evidentoj dhe regjistroj pasurin e vetë në vlerë prej 47,188,755€ dhe të siguroj një regjistër gjithëpërfshirës dhe të plotë për pasuritë jo financiare (mbi 1000€). Kjo ka rezultuar me harmonizim të regjistrit të pasurive komunale, regjistrin katastral, shënimeve në Free-balance dhe shumës së shpalosur në PFV.

Megjithatë, për sa i përket pasurisë nën 1000€ PFV janë të nënvlerësuara pasi që jo të gjitha blerjet e vitit nën 1000€ janë regjistruar.

#### Çështja 17- Sfidat në inventarizimin e pasurisë - prioritet i mesëm

**E gjetura** Komisioni i emëruar për inventarizimin e pasurisë jo financiare ka bërë inventarizimin e pasurisë për institucionet e administratës së komunës, të arsimit dhe të shëndetësisë dhe kanë hartuar raporte individuale për këta sektorë, por nuk ka arritur të bëjë hartimin e raportit të përgjithshëm dhe të bëjë barazimet me gjendjen kontabël.

Komuna edhe më tutje nuk ka hartuar procedura të brendshme të shkruara për menaxhimin e pasurive, siç kërkohet me rregulloren për menaxhimin pasurisë 02/2013.

**Rreziku** Mos hartimi i procedurave të brendshme për evidencën, ruatjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare, mund të shkaktoj vështirësi në menaxhimin dhe regjistrin e plotë dhe të saktë të pasurisë. Poashtu, mos arritja e një raporti gjithë përfshirës rrezikon që inventarizimi i pasurisë mos të paraqitet i plotë.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet të sigurohet që të formojë procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë, përfshirjen e gjitha pasurive në regjistrat e pasurisë dhe kompletimit të inventarizimit, duke hartuar edhe raportin gjithëpërfshirës për pasurinë jo financiare.

### 3.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (LL/A) janë faturimet të cilat komuna nuk ka arritur t'i realizojë si të hyra vetjake nga shërbimet e bëra dhe tatimit në pronë.

**Çështja 18 - Procedurat e faljes së borxheve - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Komuna nuk ka të vendosura procedura të brendshme për raportimin dhe regjistrimin e të gjitha llogarive të arkëtueshme si dhe nuk ka raporte të plota mbi procedurat e shlyerjes së borxhit, sepse kërkesat ligjore nuk janë aplikuar, dhe të dhënat nga tatimi në pronë nuk paraqesin pamjet reale në listën e siguruar të tatimpaguesve.
- Rreziku** Mos aplikimi i procedurave të brendshme për raportimin e borxheve dhe mos aplikimi/azhurnimi i faljes së borxheve sipas ligjit për faljen e borxheve, rrit rrezikun që komuna mos të posedoj të dhëna të sakta për të arkëtueshmet e saj.
- Rekomandimi 18** Për të ndërtuar një pasqyrë të plotë mbi llogaritë e arkëtueshme të komunës, Kryetari duhet të siguroj vendosjen e procedurave të brendshme për raportim të qartë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme dhe të aplikoj ligjin për faljen e borxheve.

### 3.3 Obligimet e papaguara

Totali i obligimeve në fund të vitit 2016 ishte 479,000€. Krahasuar me vitin e kaluar (64,000€), obligimet kanë shënuar rritje prej 415,000€. Vlera më e lartë është nga investimet kapitale, e përcjellë me shpenzimet komunale dhe mallrat e shërbimet.

**Çështja 19 - Dobësitë në menaxhimin e obligimeve - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** Në pesëmbëdhjetë pagesat e testuara në vlerë 136,409€ është vërejtur që pagesat për faturat e pranuar, kanë tejkaluar afatin ligjor<sup>5</sup> për pagesë. Përveç kësaj, komuna ka mbivlerësuar obligimet nga investimet kapitale duke i paraqitur si obligime financiare obligimet kontraktuese shumë prej 299,000€.
- Rreziku** Dështimet e pagesave me kohë ndaj furnitorëve dhe rritja enorme e obligimeve gjatë vitit 2016, rrisin rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyej obligimet e vitit paraprak si dhe tërheqja e parave mund të bëhet direkt nga Thesari nga paditë eventuale gjyqësore.
- Rekomandimi 19** Kryetari duhet që t'i marr masat e duhura me kohë për planifikim të buxhetit për t'i kryer obligimet e mbetura si dhe të caktoj politika efektive për parandalimin e hyrjeve në obligime të reja. Detyrimet financiare duhet të paraqiten në PVF vetëm atëherë kur pranohet fatura në komunë, ndërsa obligimet kontraktuese duhet të shpalosen veçmas.

<sup>5</sup> Sipas rregullës financiare 01/2013-shpenzimet e parasë publike, çdo faturë e arritur në entitet duhet të paguhet brenda 30 ditëve pas pranimit.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit                            | Rekomandimet e dhëna                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Të zbatuara | Në proces të zbatimit                                                                              | Të pa zbatuara                          |
|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|
| 2. Pasqyrat Financiare                            | Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rreziqet domethënëse për keq klasifikim të shpenzimeve dhe shpalosjen e pasurive. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime.                    |             | Është vazhduar me keq planifikime.                                                                 |                                         |
| 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak                 | Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar me adresimin e rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.                                                                                                                                                            |             | Kryetari informohet vetëm gojarisht , por nuk ka raportim me shkrim mbi zbatimin e rekomandimeve . |                                         |
| 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së | Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave.                                                                                                                                                                                                                                                               |             | Mungojnë planet operative.                                                                         |                                         |
| 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut                        | Kryetari duhet të sigurojë se identifikimi, vlerësimi i rrezikut dhe masat për reduktimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, shqyrtohen në nivelet më të larta të menaxhmentit. Më tej, duhet të sigurohet se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet. |             |                                                                                                    | E pa zbatuar, mungon lista e rreziqeve. |
| 2.5.2 Raportimi Menaxherial                       | Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga                                                                                                                                                                                                                                                                                               |             | Raportohet individualisht nga                                                                      |                                         |

|                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |  |                                                            |                                                                                                 |
|------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                          | i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme dhe efektive.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |  | secili departament, por nuk ka raportim gjithë përfshirës. |                                                                                                 |
| 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm     | Kryetari duhet të siguroj se Sistemi i auditimit të brendshëm vepron në mënyrë efektive, me fokus parësor në fushat ku rreziqet vlerësohet të jenë të larta dhe se rishikimet trajtojnë çështjet/aktivitetet e vitit aktual. Si fusha me prioritet për auditim mund të jenë: të hyrat vetjake, dhënia e subvencioneve, keqklasifikimet e shpenzimeve që po përsëriten për vite me radhë, etj. Komiteti i auditimit, gjithashtu, duhet të bëjë një plan pune ku do t'i përcaktoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit. |  |                                                            | NAB nga 6 auditime të planifikuara ka kryer vetëm 2 e njeri nga këto nuk ka qenë i planifikuar. |
| 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit | Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |  |                                                            | Shfrytëzim i ulët i buxhetit për investime kapitale.                                            |
| 3.4 Prokurimi)                           | Kryetari duhet të siguroj se në tabelat buxhetore për Investime Kapitale të vendosen vetëm ato projekte që janë të natyrës kapitale. Më tej, të kryhet një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e përmendura, dhe mangësitë e njëjta të mos përsëriten në të ardhmen.                                                                                                                                                                                                   |  |                                                            | Në tabelat buxhetore të investimeve kapitale janë vendos projekte te natyrës jo kapitale.       |
| 3.5.1 Pagesat tjera                      | Kryetari duhet të siguroj se kontrollet financiare mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve financiare fuqizohen për të siguruar se të gjitha shpenzimet realizohen duke u bazuar në ligjin e buxhetit dhe rregulloret përkatëse.                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |  |                                                            | Janë bërë pagesa nga investimet kapitale e që nuk janë të asaj natyre.                          |
|                                          | Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen, do të jetë palë aktive dhe e barabartë në përcjelljen, realizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Praktikën e tilla të financimit dhe pagesat e bëra në bazë të këtyre marrëveshjeve duhet të ndërpriten, dhe në vend të kësaj të insistohet që të gjitha pagesat të bëhen vetëm pas pranimit të shërbimeve dhe të bazuara në fatura dhe në bazë të progresit                                                                                             |  | Mungon mbikëqyrja e barabartë në realizimin e projekteve . |                                                                                                 |



|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |           |   |                                                              |
|-----------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---|--------------------------------------------------------------|
|                                         | të marrëveshjeve, dhe jo në formë paradhënie.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |           |   |                                                              |
| 3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)  | Kryetari duhet të siguroj se shpenzimet bëhen konform ndarjeve buxhetore dhe se asnjë shpenzim nuk do të bëhet nga kategoria e mallrave/shërbimeve dhe subvencione për kategorinë e pagave dhe mëditjeve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | E zbatuar |   |                                                              |
| 3.6 Të Hyrat                            | Kryetari duhet të nxis departamentet përkatëse të komunës që të zbatojnë në mënyrë strikte kërkesat e dispozitave kontraktuese ndaj personave që u janë shitur pronat apo të cilëve këto prona u janë dhënë në shfrytëzim me qira. Po ashtu, një çasje e përmirësuar e planifikimit e të hyrave mund të aplikohet duke marrë në konsiderim analizën e trendit gjatë viteve të fundit, dhe bazën aktuale të ngarkesave të tatimit në pronë dhe ndërtimeve potenciale. Çështje shqyrtimi, duhet të jetë edhe ndërtimi i strategjisë dhe mekanizmave efikas për inkasimin e borxheve nga taksat e biznesit, duke mos përjashtuar edhe masat administrative (nëse ka nevojë). |           |   | Planifikimi jo real.                                         |
| 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale | Përkundër vlerësimit tonë për punën e komisionit, ne rekomandojmë që Kryetari duhet të siguroj që regjistri i pasurisë mbi 1,000€ përmban vetëm pasuritë që janë në pronësi të komunës, dhe procesi i regjistrimit të vazhdoj deri në regjistrimin përfundimtar të të gjitha pasurive.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | E zbatuar |   |                                                              |
| 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve       | Kryetari duhet të sigurojë iniciimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |           |   | Nuk janë rivlerësuar të arktushmet në kuptim të vjetërsisë . |
| Numri i rekomandimeve                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 2         | 5 | 7                                                            |



## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 18.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës:

z.Burim Berisha

